



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primenjo/Prodato Received/Delivery	25.01	2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity	
SIKONSTAT	466/2024		1/2	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1511/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Percuku Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës numër A.nr.1511/2023, të datës 11.12.2023, të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim përfaqësohen nga nga Shtërpeca, kundër organit të punësimit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtafatshme ankesa me numër A.nr.1511/2023, e datës 11.12.2023, e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Nëpunësit civil

mëtejme referuar ankuesit), më datë 11.12.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.80/2023, të datës 25.10.2023 të U.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të: shkeljes së qenësishme të procedurës, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe gjendjes faktike e vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2023 ka proceduar kërkesën për



përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.12.2023, ka përcjellë përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesve me numër A.nr.1511/2023 e datës 11.12.2023, është e jashtëafatshme, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi janë të punësuar në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se U.d.Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me Vendimin me Nr.80/2023, të datës 25.10.2023, ka vendosur se ankuesit nga data 01.10.2023, shkojnë me zero në listën e pagave dhe se ky vendim vlen deri në zgjidhjen përfundimtare të vijueshmërisë së rregullt të tyre në punë.


Kolegji i Këshillit, në kuptim të përmbushjes së kërkesave ligjore lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.* Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe bazuar në provat materiale të çështjes, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesve është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse njësia e personelit të MRKS-së, vendimin e kontestuar me ankesë e ka përcjellë më datë 26.10.2023 (në formë elektronike) te ankuesi i cili po më datë 26.10.2023 ka konfirmuar se lidhur me këtë vendim janë njoftuar të gjithë ankuesit, kurse, ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kanë parashtruar me datë 11.12.2023, pra jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, sikurse është përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë rezulton se ankesa A.nr.1511/2023 e datës 11.12.2023, është e papranueshme.

Referuar si me lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1511/2023.

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



I dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesve
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

